



Ms. Enisa Halili LL.M.

**Bashkëpunuese në Freshfields
Bruckhaus Deringer,
Frankurt**

Financimi nga një palë tretë dhe Rregullat e ICC-së 2021

Në vitet e fundit, financimi nga një palë e tretë ka pasur popullaritet në rritje në arbitrazhin ndërkombëtar. Ky postim në formatin e blog-ut ka për qëllim të përkufizojë financimin nga një palë e tretë, si dhe të ofrojë një përmbledhje të disa përparësive dhe problemeve të mundshme praktike. Gjithashtu, vijon të trajtojë trendet e fundit e rregullave të institucioneve dhe, në veçanti, diskuton transparencën dhe kërkesat për deklarimin e financimit nga një palë e tretë në Rregullat e Arbitrazhit të ICC-së, 2021.

Përkufizimi i financimit nga një palë e tretë

Financimi nga një palë e tretë mund të përkufizohet si një marrëveshje ku një subjekt jo-palë siguron mbështetje financiare për një palë në një mosmarrëveshje. Marrëveshja mund të mbulojë një pjesë ose të gjitha shpenzimet e procedurave. Në përgjithësi, financimi do të sigurohet në këmbim të një shpërblyeri, i cili përcaktohet nga rezultati i çështjes ose në këmbim të një çmimi. Financuesit janë zakonisht fondet mbrojtëse, firmat e kapitalit privat, dhe kompani të specializuara për financimin e palëve të treta.

Përparësitë e financimit nga një palë e tretë

Financimi nga një palë e tretë është bërë

tërheqës pasi u mundëson palëve të vijnë pretendimet e tyre edhe pse u mungojnë mjetet financiare për ta bërë këtë. Por, financimi nga një palë e tretë nuk është vetëm për kompanitë të cilat kanë kufizime monetare. Duke qenë se financuesit nuk rimburohen nëse pretendimi është i pasuksesshëm, rreziku i një rezultati të pafavorshëm për palët të cilat kanë marrë financim zvogëlohet. Është gjithashtu e përshtatshme për kompanitë që dëshirojnë të ulin kostot e tyre ligjore ose t'i heqin këto shpenzime nga bilancet e tyre. Financuesit ndërmarrin një vlerësim të kujdesshëm dhe objektiv përpara se të angazhohen në një çështje, e cila mund ta ndihmojë palën që financohet për të kuptuar më mirë pikat e forta dhe të dobëta të çështjes së tyre.

Konfliktet e mundshme në lidhje me financimin nga një palë e tretë

Ndërsa mekanizmi i financimit nga një palë e tretë mund t'i lehtësojë shumë procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, ai gjithashtu ngre shqetësime praktike, të tilla si gjasat e konflikteve të interesit të krijuara nga emërimi i përsëritur i një arbitri nga i njëjti financues. Faktorët që kontribuojnë në konflikte të mundshme përfshijnë, për shembull, numrin në rritje të çështjeve të financuara nga palë të treta, numrin e kufizuar të kompanive në industrinë e financimit, si dhe marrëdhëniet e ngushta midis financuesve dhe firmave të caktuara



Ligjore. Një shqetësim tjetër është, gjithashtu, efekti që mund të ketë financimi nga një palë e tretë në autonominë e një pale, veçanërisht në kontekstin e një zgjidhjeje të mundshme, e cila mund të jetë e varur nga miratimi i financuesve.

Trendet e fundit në rregullat institucionale dhe "soft law"

Financimi nga një palë e tretë është bërë subjekt i "soft law" dhe i shumë rregullave institucionale në vitet e fundit. Çështja kryesore është zbulimi i pranisë së një marrëveshjeje financimi. Udhëzimet e IBA-s të 2014-ës, për konfliktin e interesit në arbitrazhin ndërkombëtar, për shembull, kërkojnë deklarin e ndonjë financuesi nga një palë e tretë. Në vitin 2018, një Task-Forcë e përbashkët e ICCA-së dhe Universitetit Queen Mary të Londrës publikoi një raport që identifikoi çështjet që lindin në lidhje me financimin nga një palë e tretë në arbitrazhin ndërkombëtar dhe se si duhen trajtuar këto çështje. Rregullat e fundit institucionale, gjithashtu, kanë pasqyruar zhvillimin e financimit nga një palë e tretë. Institucionet e arbitrazhit përfshirë HKIAC-në, SIAC-në, SCC-në, Dhomen e Arbitrazhit në Milano dhe ICSID-në (në Propozimet për Ndryshimin e Rregullave të ICSID-së), ose kanë përditësuar rregullat e tyre, ose kanë publikuar shënime të veçanta udhëzuese për ta trajtuar këtë çështje.

Financimi nga një palë e tretë në Rregullat e ICC-së, 2021

Para miratimit të Rregullave të ICC-së 2021, ICC-ja tashmë e kishte trajtuar deklarin e fondeve të palëve të treta në disa dokumente.

Në raportin e 2015 për vendimet në lidhje me shpenzimet në arbitrazhin ndërkombëtar, ICC-ja nuk parashikoi një qasje të detyrueshme për deklarin e fondeve nga palët e treta. Në vend të kësaj, tribunalet e arbitrazhit kishin lirinë e zgjedhjes për të diskutuar me palët nëse identiteti i financuesve duhet deklaruar. Në të njëjtën mënyrë, një tribunal arbitrazhi, gjithashtu, mund të kërkojë të zbulohet informacioni për financimin nëse beson që financimi nga një palë e tretë ekziston.

Disa versione të Shënimeve të ICC-së për Palët dhe Tribunalet e Arbitrazhit rreth zhvillimit të Arbitrazhit ("Shënimet Udhëzuese ICC")i kanë mëshuar kërkesës për zbulimin e financuesit. Në kontekstin e pavarësisë dhe paanësisë së arbitrit, Shënimet Udhëzuese të ICC-së 2016 kanë deklaruar se arbitrat, kur bëjnë deklarin, duhet të konsiderojnë "marrëdhëniet me çdo subjekt që ka një interes të drejtpërdrejtë ekonomik në mosmarrëveshje ose një detyrim për të dëmshpërblyer një palë për dhënien e vendimit". Rregullat e reja të ICC-së, të zbatueshme për arbitrazhet e regjistruara në ose pas datës 1 janar 2021, tani përcaktojnë detyrimin që palët të deklarojnë ekzistencën dhe identitetin e çdo financimi nga një palë e tretë. Neni përfshin sa më poshtë:

Neni 11(7)

Në mënyrë që të ndihmojë arbitrat e ardhshëm dhe arbitrat në përmbushjen e detyrave të tyre sipas neneve 11(2) dhe 11(3), secila palë duhet të informojë menjëherë Sekretariatit, tribunalin e arbitrazhit dhe palët e tjera, për ekzistencën dhe identitetin



e çdo jo-palë, e cila ka hyrë në një marrëveshje për financimin e pretendimeve ose mbrojtjen dhe nën të cilën ka një interes ekonomik mbi rezultatin e arbitrazhit.

Pavarësisht se zbulimi i financimit nga një palë e tretë është i detyrueshëm, ndikimi i tij shtrihet vetëm në "ekzistencën dhe identitetin" e çdo financimi nga një palë e tretë dhe nuk kërkon dhënien e një informacioni më të hollësishëm, siç janë dispozitat e marrëveshjeve të financimit. Vlen të përmendet që ICC-ja ka një qasje më të gjerë për përkufizimin e financimit nga një palë e tretë, duke iu referuar si "një marrëveshje për financimin e pretendimeve ose mbrojtjeve dhe sipas së cilës [një jo-palë] ka një interes ekonomik në rezultatin e arbitrazhit", pa specifikuar ndonjë kërkesë të jashtëzakonshme ose kushtet e marrëveshjes. Megjithatë, Shënimet Udhëzuese të ICC-së 2021 nuk hedhin shumë dritë mbi atë që mund të cilësohet "interes ekonomik", përveç situatës kur një jo-palë ka të drejtë për "të gjitha ose një pjesë të të ardhurave të dhënë në vendim". Me tej, në varësi të një vendimi nga tribunali i arbitrazhit që deklaron ndryshe, Shënimet Udhëzuese qartësojnë se rrethanat e mëposhtme, normalisht nuk do të ishin brenda fushës së deklaramit në bazë të nenit 11(7): "(i) financimi ndër-shoqëror brenda një grupi ndërmarrjesh, (ii) rregullimet e tarifave ndërmjet një pale dhe konsulentit, ose (iii) një interes indirekt, siç është ajo e një banke që i ka dhënë një hua palës gjatës aktiviteve të zakonshme të saja e jo posaçërisht për financimin e arbitrazhit".

Implikimet e nenit 11 (7) të Rregullave të ICC-së 2021

Rregullat e ICC-së 2021 kërkojnë të vendosin ekuilibër ndërmjet transparencës dhe konfidencialitetit dhe efektshmërisë së procedurave të arbitrazhit.

Së pari, neni 11(7) imponon deklaramin e çdo financimi nga një palë e tretë pranë Sekretariatit, tribunalit të arbitrazhit dhe palëve të tjera. Deklarimet e shpejta nga palët do t'i lejojnë arbitrat të bëjnë vlerësime dhe të japin vendime në kohë për konfliktet e mundshme të interesit. Në fazat e fundit të arbitrazhit, deklaramet gjithashtu do t'i mbrojnë arbitrat nga sfidimet.

Së dyti, detyrimi për të deklaruar financimin nga një palë e tretë mund të krijojë shqetësime në lidhje me konfidencialitetin dhe efektshmërinë. Për shembull, një detyrim për një deklaram të përgjithshëm që i përket kushteve të marrëveshjes së financimit të palëve mund të aludojë mbi kosidermin e strategjisë së çështjes. Ndryshe nga kjo, një deklaram më i kufizuar mund të mbrojë strategjinë e çështjes së një pale, të shmangë sfidat e panevojshme për arbitrat dhe të thjeshtojë procedurat e arbitrazhit. Kjo qasje e balancuar, e miratuar nga ICC-ja dhe e pasqyruar në kërkesat e nenit 11(7) që vetëm "ekzistenca dhe identiteti" e financimit nga një palë e tretë të deklarohet, është gjithashtu në harmoni me praktikën më të mira të sugjeruara nga Task- Forca ICC-Queen Mary për financimin nga një palë e tretë në arbitrazhin ndërkombëtar (2018).

Së treti, deklarami i financimit nga një palë e tretë mundet të ndikojë edhe në lehtësinë e administrimit të arbitrazheve. Sipas "Shënimet për Palët dhe Tribunalin e Arbitrazhin mbi Përputhshmërinë" e ICC-së, e vitit 2017, palëve mund t'u kërkohej nga



nga ICC-ja të japin informacione për subjektet më të cilat mund të kenë lidhje (i.e. “subjekte ose individë që mund të kenë lidhje me një palë në këtë çështje”) për të siguruar pajtueshmërinë me regjimet ndërkombëtare të sanksionimeve dhe implementimin e masave administrative të nevojshme. Deklarimi i detyrueshëm i financimit nga një palë e tretë parashikohet edhe kur një financues mund të jetë i renditur nën një regjim sanksionesh ndërkombëtare dhe duhen zbatuar dhe respektuar të gjitha procedurat e zbatueshme në pajtueshmëri me ICC-në.

Së fundmi, nga këndvështrimi i tribunalit të arbitrazhit, deklarimi i detyrueshëm i financimit nga palë të treta mund të lehtësojë shqetësimet për pastrimin e parave duke treguar burimin e fondeve të përfshira në arbitrazh, si dhe subjektet ose personat që përfitojnë në fund nga vendimi i arbitrazhit.

Drejt së ardhmes

Mosmarrëveshjet ndërkufitare pritet të rriten, ndërsa kompanitë përballen me rritjen e kufizimeve financiare për të ndjekur pretendimet e tyre. Prandaj, miratimi i rregullit të deklarimit nga ICC-ja është me rëndësi, pasi krijon një kornizë rregullatore për funksionimin e mekanizmave për financimin nga palë të treta. Deklarimi i detyrueshëm i ekzistencës dhe identitetit të financimit nga palë e tretë është një hap drejt rritjes së transparencës dhe ndihmon në ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet transparencës, konfidencialitetit dhe efikasitetit.

Mohim: *Pikëpamjet dhe mendimet e*

shprehura në këtë artikull janë vetëm deklarata personale të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin e ICC Albania. Autori merr përsipër çdo gabim të shprehur në artikull. Përmbajtja e artikullit është vepër origjinale e autorit. Autori merr përgjegjësinë për çdo shkelje të autorësisë. Versioni origjinal i artikullit është në gjuhën angleze

Shkurtime:

ICCA - Këshilli Ndërkombëtar i Arbitrazhit Tregtar

HKCIAC - Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit Honk Kong

SIAC - Qendra e Arbitrazhit Ndërkombëtar e Singaporit

SCC - Instituti i Arbitrazhit i Dhomës së Tregtisë së Stokholmit

ICSID - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve

Referencat:

Termi “Soft law” i referohet instrumenteve pothuajse ligjore të cilat nuk kanë ndonjë forcë ligjore të detyrueshme, ose forca detyruese e të cilave është disi më e dobët se forca detyruese e ligjit tradicional.

Rregullat e Arbitrazhit e ICC-së, <https://iccwbo.org/dispute-resolution-services/arbitration/rules-of-arbitration/>
Shënime për Palët dhe Tribunalin e Arbitrazhit për zhvillimin e arbitrazhit (2016), e ICC-së, <https://www.iccspain.org/wp-content/uploads/2015/04/Note-to-Parties-and-Arbitral-Tribunals-on-the-Conduct-of-Arbitration-22-sept-2016.pdf>
Shënime për Palët dhe Tribunalin e Arbitrazhit për zhvillimin e arbitrazhit (2021), ICC-së, <https://iccwbo.org/publication/note-parties-arbitral-tribunals-conduct-arbitration/>
Shënimet për Palët dhe Tribunalin e Arbitrazhit mbi Përputhshmërinë, e ICC-së (2017), <https://iccwbo.org/content/uploads/sites/3/2017/11/note-to-parties-and-arbitral-tribunals-on-icc-compliance-english.pdf>



Raporti i Task Forcës ICCA- Queen Mary Report of the ICCA-Queen Mary mbi Financimin nga një Palë e Tretë në Arbitrazhin Ndërkombëtar (2018), Task Forca ICCA-Queen Mary, https://cdn.arbitration-icca.org/s3fs-public/document/media_document/Third-Party-Funding-Report%20.pdf

Si mundet financimi nga një palë e tretë të ndihmojë biznesin gjatë pandemisë? Noiana Marigo, Natalia Zibibbo, <https://riskandcompliance.freshfields.com/post/102ge90/how-can-third-party-funding-help-businesses-during-the-pandemic>

Financimi nga një palë e tretë dhe vendi i tij në rregullat e reja të ICC-së, Jonathan Barnett, Lucas Macedo, Jacob Henze, <http://arbitrationblog.kluwarbitration.com/2021/01/05/third-party-funding-finds-its-place-in-the-new-icc-rules/>

Sfidat e sanksioneve për pjesmarrësit në arbitrazh, Christopher Hunt, Colin Trehearne, Eriko Kadota, <http://arbitrationblog.kluwarbitration.com/2015/10/05/the-challenge-of-sanctions-for-arbitral-participants/>

Udhëzuesi i Sekretariatit të Arbitrazhit të ICC-së, Jason Fry, Simon Greenberg, Francesca Mazza, ICC Publication 729 (Paris, 2012).

Financimi nga një palë e tretë në arbitrazhin ndërkombëtar, Hussein Haeri, Clàudia Baró Huelmo and Giacomo Gasparotti, <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=f0bf76ab-9607-4de0-92ee-70f9001277f5>

